

Datë 20/04/2026

KËRKESË

KËRKUES: _____

DREJTUAR: **KRYESISË SË PARTISË DEMOKRATIKE TË SHQIPËRISË**

KOMISIONIT TË APELIMIT DHE VLERËSIMIT TË STATUTIT

PËR DIJENI: **FLAMUR NOKA** **SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I PDSH-SË**

SALI BERISHA **ISH KRYETAR I PDSH-SË**

OBJEKTI: Konstatimin e mbarimit të mandatit të Z.Sali Ram Berisha si Kryetar i Partisë Demokratike të Shqipërisë.

Komandimin e Sekretarit të Përgjithshëm të PDSH-së Z.Flamur Noka në detyrën e Kryetarit të Komanduar të PDSH-së deri në zgjedhjen e kryetarit të ri.

Ndalimin e kandidimit të shtetasit Sali Ram Berisha për pozicionin e Kryetarit të PDSH-së në zgjedhjet e datës 23.05.2026 sipas Vendimit të Kryesisë së PDSH-së nr.35 datë 17.03.2026

B.LIGJORE: Neni 46, 48, 50 dhe 54, të Statutit të Partisë Demokratike të Shqipërisë.

TË NDERUAR ANËTAR TË KRYESISË!

TË NDERUAR ANËTAR TË KAVS!

Unë _____ jam anëtar i PDSH-së q prej datës _____ dhe më parë kam qënë zgjedhur si anëtar i _____ dhe kam mbajtur funksionin _____ fakte të vërtetuar dhe nga Karta e Anëtarësisë si dhe nga Lista e Anëtarëve të _____ e cila disponohet nga ana e Sekretariatit Organizativ pranë PDSH-së. Gjithashtu unë kam marrë pjesë në Kuvendin Kombëtar të PDSH-së të datës 11.12.2021 në Stadiumin Air Albania datë në të cilin është miratuar dhe Statuti i PDSH-së i cili është në fuqi aktualisht.

Rezulton se me anë të Vendimit të Kryesisë së PDSH-së nr.35 datë 17.03.2026 është përcaktuar që zgjedhjet për Kryetar të PDSH-së do të zhvillohen në datën 23.05.2026 dhe në zbatim të këtij vendimi janë nxjerr deh udhëzimet përkatëse për organizimin e procesit zgjedhor sipas përcaktumeve statutore dhe rregulloreve të brendëshme të partisë.

Në respekt të aksionit opozitar dhe qëllimit për të mbrojtur çdo votë të demokratëve nuk kam ndërmarrë asnjë veprim statutor dhe procedurial pasi kam shpresuar gjatë që Kryesia si organ kolegjal dhe i zgjedhur në mënyrë demokratike si dhe nga ana e Komisionit të Apelimit dhe Vlerësimit të Statutit mbas mbarimit të periudhës së amnezisë politike të shkaktuar nga humbja

e thelle elektorale do të merrnit hapat e nevojshëm për vendosjen e legjitimitetit dhe sbatimin e kushtetutës së PDSH-së pikërisht statutin e saj.

Siç jeni në dijeni të nderua në datën 28.08.2025 me anë të Vendimit me Nr. 34 të Komisionit Rregullator është marrë vendimi “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 11 maj 2025” ku rezulton se Partia Demokratike ka humbur thellë zgjedhjet e përgjithshme parlamentare madje duke marrë dhe një rezultat shumë më të dobët se zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të vitit 2021.

Nga ana e PDSH-së u krye dhe ankimi në Kolegjin Zgjedhor i cili me 5 vota pro në lidhje me kërkesën e PDSH-së me anë të vendimit me Nr.30 datë 04.09.2025 të vendosur:

1. *Rrëzimin e kërkesë padisë*
2. *Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim*

Qartësisht ky vendim është përfundimtar dhe i zbatueshëm nga të gjithë institucionet e Republikës së Shqipërisë. Duke u bazuar në Vendimin me Nr. 34 të Komisionit Rregullator dhe të Vendimit Nr.30 datë 04.09.2025 të Kolegjit Zgjedhor, Presidenti i Republikës dekretojë dhe qeverinë e re të dalë nga këto zgjedhje duke mandatuar Edi Ramën si kryeministër të RSH.

Qartësisht ky rezultat u pranua dhe nga ana juaj të nderuar pasi me një sër vendimarrjesh të organit tuaj ju pranuat rezultatet e dala nga këto zgjedhje duke u bërë pjesë aktive e jetës parlamentare si dhe duke marr pozicionet kushtetuese që i takojnë opozitës madje dhe me disa vendimarrje të juajat si kryesi ju zgjodhët Kryetarin e Grupit Parlamentar, Zv?Kryetarin e Parlamentit, Anëtarët e Komisioneve të Përherhshme Parlamentare si dhe Anëtarët e Komisioneve të Posaçme Parlamentare, pra qartësisht keni ndërmarrë veprime institucionale që tregojnë qartësisht respektimin nga ana e PDSH-së të rezultatit të zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare të 11.05.2025 të certifikuara me Vendimin me Nr. 34 të Komisionit Rregullator dhe me Vendimin Nr.30 datë 04.09.2025 të Kolegjit Zgjedhor.

TË NDERUAR ANËTAR TË KRYESISË! TË NDERUAR ANËTAR TË KAVS!

Që prej datës 04.09.2025 nga ana juaj nuk është ndërmarrë asnjë veprim ligjor dhe organizativ për të zbatuar përcaktimet statutores duke konstatuar kryesisht përfundimin e mandatit të kryetarit të PDSH-së, Z.Sali Ram Berisha. Në zbatim të statutit të PDSH-së dhe më konkretisht të Nenit 46 pika 8 e tij këtij shtetasi i ka përfunduar mandati që në datën 04.09.2025 datë e cila përkon dhe më certifikimin përfundimtar të rezultati zgjedhor me anë të Vendimit me Nr. 34 të Komisionit Rregullator dhe të Vendimit Nr.30 datë 04.09.2025 të Kolegjit Zgjedhor dhe të njohur me veprime konkludentë nga ana e PDSH-së.

Në nenin 46 pika 8 e Statutit përcaktohet se:

8. Në rast se pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve të përgjithëshme për Kuvendin, Partia nuk rezulton forcë fituese qeverisëse, mandati përfundon menjëherë dhe automatikisht për shkak të Statutit. Në këtë rast, kryetarit që i përfundon mandati, nuk i lejohet kandidimi në zgjedhjet pasardhëse për kryetar partie.

Siç përcakton qartë kjo dispozitë mandati i kryetarit ka mbaruar që në datën 04.09.2025 dhe që prej asaj datë shtetasi Sali Ram Berisha nuk mund të ushtojë më funksionet e kryetarit të PDSH-së pasi një veprim i tillë bien ndesh me një dispozitë urdhëruese të Statutit.

Në zbatim të nenit 48 të Statutit është detyra e Kryesisë së PDSH-së që në mungesë të vullnetit institucional të uzurpuesit të pozicionit të kryetarit të PDSH-së të ndërmarrë veprimet e nevojshme institucionale për të vendosur në vënd legjitimitetin e organeve drejtuese të PDSH-së.

Statuti ka përcaktuar qartë dhe veprimet që do të duhet të merren nga ana e organeve qëndrore të partisë në momentin që kryetari i mbaron mandati sipas pikës 7 ose 8 të nenit 46 të tij. Më konkretisht ky statut në pikën 5 të nenit 46 përcakton qartë se funksionet e kryetarit që i ka mbaruar maandati deri në oiragbizimin e zgjedhjeve të tjera i merr pikërisht Sekretari i Përgjithshëm dhe më konkretisht aktualisht në detyrë dhe brënda mandatit 4 vjeçar është shtetasi Flamur Noka i cili në zbatim të rregullave statutorë do të duhet të kishte zbatuar detyrat e Kryetarit të Komanduar të PDSH-së që prej datës 04.09.2025.

Për të qënë më specifik rezulton që në pikën 5 të nenit 46 të statutit përcaktohet se:

5. Në rastet e përfundimit të parakohshëm të mandatit, funksionet e Kryetarit ushtrohen nga Sekretari i Përgjithshëm, deri në zgjedhjen e kryetarit të ri.

Qartësisht Kuvendi Kombëtar kur ka miratuar Statutin e PDSH-së ka përcaktuar qartë se si do të funksionojë partija kur humben zgjedhjet dhe se cilat janë hapat statutor që do të duhet të ndërmerren dhe që janë të detyrueshëm për organet qëndrore të partisë. Siç shihet qartësisht në asnjë rast anëtarët e Kuvendit Kombëtar të PDSH-së nuk kanë pranuar që të ketë përcaktime të tjera statutorë që do të lejonin vazhdimin e mandatit të kryetarit që ka humb zgjedhjet.

Për sa më sipër është e qartë se Sekretari i Përgjithshëm do të duhet të ngarkohet me kryerjen e detyrave të Kryetarit të PDSH-së deri në zgjedhjen e kryetarit të ri dhe nga ana e Kryesisë do të duhet të ndërmerren të gjitha hapat procedurial për të zbatuar përcaktimet e këtij statuti i cili është në fuqi pas një beteje të gjatë gjyqësore dhe se parimet e vendosura në të triumfuan si parimet me demokratike në jetën politike të Republikës së Shqipërisë.

Për sa i përket pikës së tretë të kërimit besoj që dhe ajo është fare e qartë dhe tanimë një parim i konsoliduar dhe në zgjedhjet për Kryetar të Degëve të PDSH-së në kur qartësisht humbësit nuk janë rikandiduar si një pengesë statutorë dhe sipas parimit të përcaktuar për Kryetarin e PDSH-së.

Siç kuptohet qartë shtetasi Sali Ram Berisha ka pengesë statutorë për të kandiduar pasi ai rezulton që ka qënë kryetar i PDSH-së kur janë zhvilluar zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të datës 11.05.2025 rezultati i të cilave është çertifikuar me anë të Vendimit me Nr. 34 të Komisionit Rregullator dhe të Vendimit Nr.30 datë 04.09.2025 të Kolegjit Zgjedhor dhe njohur dhe respektuar me veprime konkludentë nga ana e PDSH-së.

Në pjesën e dytë të pikës 8 të nenit 46 të statutit përcaktohet qartë se: **...Në këtë rast, kryetarit që i përfundon mandati, nuk i lejohet kandidimi në zgjedhjet pasardhëse për kryetar partie**

Kjo dispozitë është e qartë dhe e detyrueshme për tu zbatuar nga çdo organ i PDSH-së e cila ka për detyrë për të organizuar zgjedhjet për kryetar të PDSH-së si dhe për të miratuar kandidaturat që do të marrin pjesë në këtë proces zgjedhor.

Normalisht një pikë e tillë nuk do të duhet të ishte pjesë e kësaj kërkesë pasi afërmendsh nuk mund të besohet që një organ kolegjal kaq prestigjioz mos të njoh dhe të respektojë dispozitat statutore të cilat i kanë miratuar plot 5 mijë delegatë të Kuvendit Kombëtar të datës 11.12.2021. Arsyeja që po e bëj këtë kërkim në mënyrë të veçant ka të bëjë me qëndrimet publike të shtetasit Sali Ram Berisha i cili deklaroi me bindje të plotë që do kandidojë në zgjedhjet që do të organizohen për Kryetar të PDSH-së në datën 23.05.2026.

Jam i bindur që ju si Organi më i lartë Ekzekutiv i Partisë Demokratike nuk do të pranoni që askush të nëpërkëmb autoritetin tuaj statutor duke ju poshtëruar publikisht madje dhe duke përcaktuar dhe vendimarrjen tuaj panvarësisht se ajo bie ndesh me Statutin e PDSH-së. Një qëndrim i tillë është totalisht i pa pranueshëm dhe cënon rëndë demokracinë e brendëshme të partisë si dhe nëpërkëmb dhe poshtëron autoritetin e këtij organi kaq të rëndësishëm si dhe autoritetin e secilit prej jush si anëtarë të këtij organi. Për sa më sipër jam i bindur që nga ana juaj do të merren të gjitha hapat e nevojshme dhe imediate për të vendosur partinë në shinat e statutit dhe për ta kthyer atë në duart e anëtarëve duke i hequr drejtimin uzurpatorit që në mënyrë të paligjshme e drejton që prej datës 04.09.2025.

Gjithashtu për sa referuam më sipër dhe në zbatim të dispozitave të Statutit të PDSH-së dhe më konkretisht të nenit 48 dhe 54 do të kërkojmë nga ana juaj që të merrni në shqyrtim këtë kërkesë dhe të merrni vendime të menjëherëshme duke komanduar Sekretarin e Përgjithshëm Z.Flamur Noka në detyrën e Kryetarit të Komanduar të PDSH-së deri në zgjedhjen e kryetarit të ri. Gjithashtu nëse nga ana juaj do të ketë paqartësi për zbatimin e statutit do të ishte me vënd që nga ana juaj të bëhet një interpretim përfundimtarë për të analizuar vendimarrjet e Kryetarit të PDSH-së nga data 04.09.2025 deri në përfundimin e mandatit të tij që po kërkohet nga ana ime dhe që duhet të merret një orë e më parë nga ana e Kryesisë.

Në këtë vendimarrje të përcaktohen qartë efektet ligjore të vendimeve të marra nga shtetasi Sali Ram Berisha pasi çdo vendimarrje e tij pas datës 04.09.2025 ka shkaqe të pavlefshmërisë absolute dhe si të tilla asnjë prej këtyre vendimeve nuk mund të sjellë pasoja ligjore për sa kohë që organi që i ka ndërmarrë ato nuk ka qënë në funksion pasi mandati i ka përfunduar në datën 04.09.2025 në zbatim të Vendimit me Nr. 34 të Komisionit Rregullator dhe të Vendimit Nr.30 datë 04.09.2025 të Kolegjit Zgjedhor dhe njohur dhe respektuar me veprime konkludentë nga ana e PDSH-së.

Duke shpresuar ne reagimin tuaj të menjëhershëm dhe në organizimin sa më parë të mbledhjes së Kryesisë së PDSH-së do të kërkoja që të sbatoni dispozitat urdhëruese të statutit dhe të respektoni mundin dhe sakrificën e mbi 5 mijë delegatëve dhe 10 mijë anëtarëve të PDSH-së që në kohëra të acarta në Kuvendin Kombëtar të PDSH-së përcaktuan në mënyrë unanime rregullat që do të duhet të zbatohen nga secili prej organeve drejtuese të PDSH-së si dhe nga çdo funksionar i çdo niveli i saj.

Për sa më sipër kërkojmë:

- Konstatimin e mbarimit të mandatit të Z.Sali Ram Berisha si Kryetar i Partisë Demokratike të Shqipërisë.
- Komandimin e Sekretarit të Përgjithshëm të PDSH-së Z.Flamur Noka në detyrën e Kryetarit të Komanduar të PDSH-së deri në zgjedhjen e kryetarit të ri.
- Ndalimin e kandidimit të shtetasit Sali Ram Berisha për pozicionin e Kryetarit të PDSH-së në zgjedhjet e datës 23.05.2026 sipas Vendimit të Kryesisë së PDSH-së nr.35 datë 17.03.2026

Me respekt
